

# PASQYRË E ZBATIMIT TË LIGJIT PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE DHE MËSIMET E NXJERRA



# PASQYRË E ZBATIMIT TË LIGJIT PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE DHE MËSIMET E NXJERRA

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Qeverisje Demokratike**

Publikimi: **Korrik, 2021**

Foto e ballinës: **Pexels**



Zhvillimi i Qëndrueshëm  
Sustainable Development

## Instituti për Politika Zhvillimore - INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



Fondacioni i Kosovës  
për Shoqëri të Hapur

Programi i INDEP për Qeverisje Demokratik mbështetet nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

## Përmbajtja

Hyrje .....	2
- Masa 1 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore.....	3
- Masa 2 – TRUSTi.....	4
- Masa 3 – Tatimin mbi Vlerën e Shtuar .....	5
- Masa 4 – Përkrahja e tatimpaguesve .....	6
- Masa 5 – Agjencia Kosovare e Privatizimit.....	7
- Masa 6 – Përkrahja e ndërmarrjeve private.....	8
- Masa 7 – Pagat e punëtorëve.....	9
- Masa 8 – Përparësitë për prodhuesit.....	10
- Masa 9 – KPMM .....	11
- Masa 10 – BRE .....	12
Përfundime.....	13
Rekomandime .....	15

## Hyrje

Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike Covid-19 ishte miratuar në fund të vitit 2020, ani pse hartimi i tij dhe përpjekjet për miratim kishin qenë qysh muaj para kësaj. Vonesat në miratimin e Ligjit, që vinin kryesisht nga mungesa e koncensusit politik, ndikuan edhe në kualitetin e pakos, ku ndryshime dhe amendamente të nevojshme ishte e pamundshme të miratoheshin, por edhe në nivelin e zbatimit të masave, pasi një pjesë e tyre u miratuan shumë vonë. Të gjitha këto ndikuan që Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike – Covid-19 të mos zbatohet sa duhet.

Instituti INDEP, me përkrahje të Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) ka bërë monitorimin sistematik të zbatimit të Ligjit Nr. 07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike -Covid-19. Ky monitorim ka përfshirë analizë të përmbajtjes, intervista me akterët kyç të implementimit të pakos si dhe mbledhje dhe analizim të të dhënave.

Gjatë monitorimit të zbatimit të Ligjit, INDEP ka hartuar dhjetë (10) buletine informuese për secilën nga dispozitat kryesore të Ligjit Nr. 07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike -Covid-19. Këto buletine kanë shtruar rrugën që monitorimi të ishte kontinuel, t'i përgjigjej në kohë reale ndryshimeve në zbatim dhe që të kishte mbledhje të të dhënave në kohë reale.

Kjo analizë është punimi përfundimtar i serisë së punimeve dhe buletineve që kanë shtjelluar rimëkëmbjen ekonomike nën dritën e zbatimit të këtij Ligji. Është organizuar në atë mënyrë që për secilën nga dispozitat kryesore të këtij ligji ne kemi vendosur

masën, objektiven kryesore të saj dhe kemi matur nivelin e zbatimit të saj.

Matja e nivelit të zbatimit të masave është bërë duke përdorur nivelin e shkallës së zbatimit me përqindje. Kjo mënyrë ka mundësuar një matje horizontale të nivelit të zbatimit për secilën nga masat.

Pasi që masat janë vlerësuar dhe është kuantifikuar zbatimi i tyre, janë hartuar grafikone dhe janë vendosur krahas secilës masë. Përveç shkallës deri në 100 të nivelit të zbatimit, është përdorur edhe statusi i zbatimit në tre nivele “zbatuar”, “në zbatim” dhe “pa zbatuar”.

Në fund janë listuar përfundimet dhe janë hartuar rekomandime që i drejtohen institucioneve të ndryshme. Rekomandimet janë hartuar duke pasur parasysh kontekstin kohor të hartimit të tyre, pra duke pasur parasysh faktin që zbatimi i Ligjit është kah fundi i ciklit të tij por edhe faktin që tashmë Qeveria e re ka paralajmëruar pako të reja të rimëkëmbjes.




## - Masa 1 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L – 057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.

### Objektivi:

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) ka synuar që përmes skemës garantuese të arrijë sigurimin e likuiditetit - financiar.



■ Zbatuar ■ Ende ne zbatim ■ Pa zbatim

URL: <https://fondikgk.org/wp-content/uploads/2021/06/Zhvillimi-i-portfolios-SHQ-Prill-2021.pdf> (i qasur më qershor 2021)

Themelimi i dritareve garantuese të reja nga ana e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore ishin hapat e parë drejt fillimit të zbatimit të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. FKGK krijoi dritaret garantuese në mënyrë që ky nen të i përfshijë sektorët e ndryshëm në rimëkëmbjen ekonomike të vendit. Këto dritare ishin:

- Prodhuese
- Agrobizneset
- Shërbyese
- Tregtare
- Gratë në biznes
- Start up në ICT

Përmes këtyre dritareve, FKGK ka lëshuar numër të madh të kredive që vetëm derimë 31 maj 2021, vlera e kredisë sa i përket kësaj çështje arrinë 37,553,900 euro, kurse vlera e garancisë arrinë shumën deri 26,727,820 euro.

Ndikimi i kësaj mase në rimëkëmbjen ekonomike është vërejtur që në muajt e parë të miratimit të kësaj mase (dhjetor 2020 – janar 2021). Vetëm nëse bëjmë një krahasim gjatë këtyre muajve<sup>1</sup> me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është dalluar një rritje prej 40% të fluksit të aplikimeve për kredi.<sup>2</sup> Kjo masë ka gjetur zbatim të lartë në praktikë duke ndihmuar në këtë mënyrë bizneset në rrugën e tyre drejt rimëkëmbjes ekonomike. Kjo vlerë padyshim se pritet të rritet muajve në vijim, duke pasur parasysh se kjo masë është valide deri në fund të vitit 2021.

<sup>2</sup> Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), 2021, Zhvillimi i Portfolios maj 2020, e qasshme në: <https://fondikgk.org/wp-content/uploads/2020/08/Zhvillimi-i-portfolios-SHQ-Maj-2020-1.pdf> (i qasur më qershor 2021)


## - Masa 2 – TRUSTI

**Plotësimi dhe Ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L – 101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L – 115, me Ligjin 04/L – 168 dhe Ligjin Nr. 05/L-116**

### Objektivi:

Qeveria e Kosovës ka përfshirë tërheqjen e 10 përqindëshit të kontributeve personale nga ana e qytetarëve, në mënyrë që të kjo masë të ndihmojë në rimëkëmbjen ekonomike të vendit së bashku edhe me masat e tjera që përfshinë ky ligj.

Mundësia që u ofrua qytetarëve të Kosovës për tërheqjen e 10% të kursimeve të tyre nga



Fondi i Kursimeve Pensionale ishte ndër masat kryesore që u zbatuar tërësisht në aspektin praktik. Kjo pasiqë përmes kësaj mase, qytetarët patën mundësi të tërheqnin shumën e tyre pa u tatuar dhe gjithë kjo me qëllim rimëkëmbjen e vendit. Kjo mundësi bëri që shumë qytetar të Kosovës të regjistrohen dhe të aplikojnë për tërheqjen e 10 përqind të kursimeve të tyre.

Prej gjithsej 644,582 aplikuesve të mundshëm, 427,363<sup>3</sup> ishte numri i aplikuesve të cilët e shfrytëzuan të drejtën e tyre për tërheqjen e kësaj shume. Të tjerët zgjodhën që të mos shfrytëzonin këtë mundësi e cila kishte për qëllim ndihmën dhe përkrahjen e qytetarëve duke parë se kishte filluar të rëndohet gjendja ekonomike e vendit nga pandemia COVID-19. Prandaj mund të themi se zbatimi i kësaj mase është mjaft i lartë në periudhën kur e gjithë vendi ishte në gjendje pandemie.

Se kjo masë gjeti zbatim dhe u shfrytëzuar nga ana e qytetarëve të Kosovës, tregon edhe vet fakti se vetëm gjatë muajit dhjetor 2020 kanë aplikuar 397,557. Këto shuma të tërhequra kanë ndikuar direkt në rritje të eksportit dhe importit të vendit menjëherë në muajt në vijim, duke filluar nga janari i vitit 2021. Ekonomia e vendit filloi të ketë rritje prej prej (47.1%) për eksport si dhe (6.6%) për import duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020.<sup>4</sup>


<sup>4</sup> Agjenci e Statistikave të Kosovës, 2021, Statistikat e tregtisë së jashtme – janar 2021. E qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-stj-janar-2021> (e qasur në maj 2021)

## - Masa 3 – Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

### Objektivi:

Përkrahja e sektorit privat, veçmas sektorit të gastronomisë përmes uljes së TVSH-së nga 18 përqind në 8 përqind.



■ Zbatuar ■ Ende ne zbatim ■ Pa zbatim

~ Qeveria e Kosovës, ZUZU, LIGJI NR 05// L – 016 për Rimëkëmbje Ekonomike. E qasshme në: <https://gzk.rks->

Sektori i gastronomisë ishte ndër sektorët e prekur rëndë nga pandemia COVID-19. Qeveria e Kosovës kishte paraparë përmes nenit 7 të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike të përcaktonet përkrahjen e këtij sektori. Kjo përkrahje konsistonte në uljen e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar për këtë sektor.

Ulja e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar për furnizimin e hoteleve, restoranteve dhe shërbimeve të ushqimit ishte e mirëpritur nga ana e sektorit të gastronomisë. Kjo ulje ishte paraparë të ishte nga 18% sa ishte vlera e TVSH-së në 8%. Kjo masë pritet të zbatohet deri në fund të vitit 2021.<sup>5</sup>

Kjo masë ka filluar zbatimin qysh me miratimin e ligjit Kjo pasiqë sektori i gastronomisë është cilësuar si njëri nga sektorët më të dëmtuar gjatë pandemisë COVID-19.

Në mënyrë që zbatimi i kësaj mase të jetë gjithëpërfshirës dhe i rregullt, të dhënat rreth bizneseve në sektorin e gastronomisë që operojnë në Kosovë janë të marr nga Agjencia Statistikore e Kosovës (ASK). Këto të dhëna janë përgatitur nga ASK e cila përmbanë informacione rreth të gjitha bizneset të cilat janë të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK). Këto të dhëna janë përdorur nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe janë vërtetuar se këto biznese janë biznese që ushtrojnë aktivitete ekonomike brenda Kosovës.


[gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35478](http://gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35478) (e qasun në qershor 2021)

## - Masa 4 – Përkrahja e tatimpaguesve

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-102, me Ligjin 04/L-115 dhe me Ligjin Nr. 04/L-223

### Objektivi:

Përkrahja e tatimpaguesve që kanë obligime tatimore të papaguara nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2020 me qëllim rimëkëmbjen ekonomike.



<https://gzk.rks->

Përmes kësaj mase është paraparë që të lirohen nga interesi të gjithë tatimpaguesit të cilët kanë obligime tatimore të papaguara që kanë ndodhur prej datës 01.01.2020 nëse i paguajnë këto obligime deri më datën 31.12.2020.<sup>6</sup> Kjo masë sado që ka paraparë përkrahje të tatimpaguesve përmes lirimit nga interesi, ka mbetur e paprekuar dhe e padobishme për qëllimin që e kishte. E gjithë kjo pasiqë datat e vendosura në nenin 9 të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike nuk përkojnë dhe nuk lënë kohë të mjaftueshme për të u zbatuar ky nen.

Prandaj, duke pasur parasysh se ky ligj u miratua qysh në mes të muajit dhjetor 2020, kjo masë ka mbetur tërësisht e pazbatuar. Koha e paraparë për zbatimin e kësaj mase dhe vonesat që u shkaktuan në miratimin e këtij ligji ishin në mospërputhje, sidhe rishqyrtimi i përmbajtjes së kësaj pike ishte i mangët. Kjo edhe ka ndikuar drejtpërdrejtë në mos mundësinë e shfrytëzimit të kësaj mase nga ana e qytetarëve të Kosovës.

Kjo masë ka mbetur tërësisht e pazbatuar, dhe Administrata Tatimore e Kosovës deri më tani nuk ka ndërmarrë hapa që ky nen të plotësohet apo ndryshohet përmes udhëzuesve administrativ apo formave tjera. Kjo pasiqë kjo masë do ndihmonte të gjithë tatimpaguesit të cilët janë të rregullt në kryerjen e obligimeve të tyre, të lirohen nga interesi i këtyre pagesve ndaj Administratës Tatimore të Kosovës.

[gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35478](http://gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35478) (e qasur në qershor 2021)



---

## - Masa 5 – Agjencia Kosovare e Privatizimit


**Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115, me Ligjin 05/L-080 dhe me Ligjin Nr. 06/L-023**

Kjo masë ka paraparë ndryshimet që ndodhin në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike. Kjo pasiqë këto fonde do përdoren për investime që do ndihmojnë në ngritjen e ekonomisë së vendit dhe kështu do ndihmojnë drejtpërdrejtë në rimëkëmbjen ekonomike të vendit.

Kjo masë ende nuk ka gjetur zbatim të tërësishëm, por që pritet se zbatimi i saj do jetë më i madh deri në fund të vitit, kur edhe pritet edhe miratimi i pakove të reja të cilat kanë për qëllim kryesor rimëkëmbjen ekonomike të vendit si pasojë e pandemisë

### Objektivi:

Fonde që do përdoren për investime që do ndihmojnë në ngritjen e ekonomisë së vendit dhe kështu do ndihmojnë drejtpërdrejtë në rimëkëmbjen ekonomike të vendit.




## - Masa 6 – Përkrahja e ndërmarrjeve private

### Përkrahja e ndërmarrjeve private

#### Objektivi:

Përkrahja e ndërmarrjeve private të cilat janë të regjistruara në Administratën Tatimore të Kosovës me shumën prej 200 milion euro.



■ Zbatuar ■ Ende ne zbatim ■ Pa zbatim

Kosovës, 2021. E qasshme në:

<https://kryeministri.rks-gov.net/wp->

Përkrahja e ndërmarrjeve private përmes nenit 11 të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike ishte përcaktuar përmes shumë 200 milion euro nga ana e Qeverisë së Kosovës. Kjo masë gjatë muajve të parë të vitit 2021 nuk kishte zhvillime të mëdha. Kjo masë filloi zbatimin qysh në muajin prill të vitit 2021, kur edhe Qeveria e Kosovës mori vendim për mbështetje të bizneseve të prekura nga mbyllja e cila ndodhi për dy javë rresht gjatë po atij muaji.

Qeveria e Kosovës përmes Vendimit Nr. 01/05,<sup>7</sup> i datës 05.04.2021 ka mbështetur bizneset të cilat janë prekur më shumë gjatë si pasojë e mbylljes së përkohshme që ka rezultuar pas marrjes së Vendimit Nr. 01/05, i datës 05.04.2021. Ky subvencionim ka arritur vlerën prej 6 milion euro. Këto mjete janë shpërndarë nëpër biznese përmes disa mënyrave. Ndër to përfshihet:

- subvencionimi i pagës së punëtorëve bëhet deri në nivelin 50% të pagës neto të të punësuarve e llogaritur mbi pagën bruto dhe duke qenë i liruar nga tatimi sipas legjislacionit në fuqi, deri në maksimum prej 500 EUR.
- lirimi i pagesës së qerasë për bizneset të cilat kanë qenë të mbyllura gjatë asaj kohe. Përtues të kësaj mase ishin shumë biznese ku ndër 50 ishin biznese të mëdha me numër të madh të punëtorëve.

Kjo masë është më se e nevojshme, duke parë se sektori privat është direkt i involvuar në ekonominë e vendit.


<content/uploads/2021/04/Vendimet-e-Mbledhjes-se-7-te-te-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves.pdf> (e qasur në prill, 2021).

## - Masa 7 – Pagat e punëtorëve

### Pagat e punëtorëve në sektorin privat

#### Objektivi:

Përkrahja e punëtorëve me nga 300 euro për tre muaj të cilët kanë qenë të pezulluar puna ose të larguar gjatë periudhës së pandemisë.



■ Zbatuar ■ Ende ne zbatim ■ Pa zbatim

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, Qevria e Kosovës kishte paraparë që të paguheshin pagat e punëtorëve të sektorit privat. Këto paga do të iu paguheshin të gjithë punëtorëve të sektorit privat për periudhën tetor-dhjetor 2020, të cilët si pasojë e pandemisë janë larguar apo pezulluar nga puna për jo më pak se 3 muaj, pas datës 29 shkurt 2020, deri më 30 dhjetor 2020. Shuma e pagesës për këta punëtorët nga ishte paraparë që të ishte nga 300 euro për tre muaj.

Duke pasur parasysh se Agjencia e Statistikave të Kosovës ende nuk ka të dhëna të sakta zyrtare rreth numrit të saktë të punëtorëve të cilët kanë humbur punat e tyre gjatë periudhës së pandemisë sidhe të atyre të cilët janë pezulluar nga puna gjatë muajve kritik, zbatimi i kësaj masë bëhet edhe më i vështirë. Kjo pasiqë edhe regjistrimi i punëtorëve të cilët punojnë në sektorin privat nuk është i tërësishëm. Kjo vështirëson edhe më shumë zbatimin e kësaj mase. Miërpo ajo çfarë e pengon më së shumë zbatimin e kësaj mase është edhe sqarimi i mangët i përbajtjes së kësaj mase. Kjo pasiqë pandemia COVID – 19 ka zgjatur edhe gjatë gjashtëmuajorit të parë të viti 2021, dhe ekonomia e vendit nuk është rritur menjëherë.


Prandaj kjo masë mbetet ende konfuze dhe zbatimi i kësaj masë mbetet i papërfillshëm. dhe nuk ka filluar edhe pas një viti pandemie. Kjo pasiqë këto pagesa janë menduar të shpërndahen gjatë vitit të kaluar, duke rënë këshutu ndesh me kohën kur ky ligj është miratuar. Në kuadër të zbatimit të kësaj mase duhet vepruar muajve në vijim në mënyrë që të rritet impakti i këtij ligji në rimëkëmbjen ekonomike të vendit dhe në përkrahjen e qytetarëve të Kosovës.

## - Masa 8 – Përparësitë për prodhuesit

### Përparësitë për prodhuesit e produkteve dhe shërbimeve vendore përgjatë pandemisë COVID-19

#### Objektivi:

Përkrahja e prodhuesve vendorë dhe shërbimeve vendore përmes dhënies së përparësisë gjatë vlerësimit të ofertave.



Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike përmes nenit Neni 13 - ka përfshirë mbështetjen e prodhuesve vendorë. Përmes këtij neni, Qeveria ofron përkrahje për prodhuesit vendorë me qëllim rimëkëmbjen ekonomike të vendit e cila pësoi rënie nga pandemia COVID – 19 duke larguar këshu TVSH-në për transaksionet e sigurimit dhe ri-sigurimit në bujqësi, për policat e sigurimeve bujqësore për kulturat bujqësore në Kovovë

Duhet theksuar gjithashtu se Qeveria e Kosovës nuk ka larguar bligimin për pagesat e TVSH nga të gjitha sektoret. Kjo vlenë sidomos të theksohet se të gjithë personat e tatueshëm të cilët janë të regjistruar për TVSH, nuk e gëzojnë të drejtën e zbritjes së TVSH për disa nga përdorimet. Ato janë:

- Blerjet e mallërave dhe shërbimeve, të cilat i përdorë për qëllim të realizimit të transaksioneve të sigurimit dhe ri-sigurimit në bujqësi, dhe
- Për policat e sigurimeve bujqësore për kulturat bujqësore


Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike ka paraparë edhe se gjatë vlerësimit të ofertave që dorëzohen nga prodhuesit vendorë dhe shërbimeve vendore, të u jepet përparësi në mënyrë që të u ndihmohet me qëllim të rimëkëmbjes së tyre. Edhe pse si masë e rregulluar përmes nenit 13 të këtij ligji, zbatimi i tij mbetet shumë i pakët, e mos të themi aspak i knaqshëm. Kjo edhe për arsyen se për shkak se vendi gjatë vitit 2021 dhe në disa periudha të vitit 2021 nuk ka qenë i hapur për oferta sa i përket prodhuesve vendorë. Kjo për shkak se pandemia shkaktoi mbyllje të disaherëshme të tërësishme të cilat ndikuan negativisht në zhvillimin dhe përkrahjen e prodhuesve vendorë. Kjo masë pritet që të gjejë zbatim më të lartë në muajt në vijim deri në fund të këtij viti.

## - Masa 9 – KPMM

**Plotësimi dhe Ndryshimi i Ligjit Nr. 03/L-163 për Minerat dhe Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158**

### Objektivi:

Lirimi i pagesës së rentës minerare për të gjitha subjektet të cilat janë të obliguara të paguajnë këtë tarifë për periudhën janar-maj 2021.



■ Zbatuar ■ Ende ne zbatim ■ Pa zbatim

minerare. E qasshme ne:  
<https://kosovominig.org/wp->

Lirimi i subjekteve të cilat obligoheshin të paguanin rentën minerare ishte përcatuar përmes nenit 14 të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Përmes këtij neni, subjektet liroheshin nga ky obligim i cili i sillte Qeverisë së Kosovës të ardhura mjaft të larta. Kjo masë cilësohet si masë e cila favorizoi vetëm disa subjekte të cilat ishin më të involvuara në këtë sektor.

Vlen të theksohet se KPMM pas miratimit të këtij Ligji, ka bërë plotësim/ndryshimin e këtij vendimi duke qartësuar që subjektet, në këtë rast ndërmarrjet, do të lirohen nga pagesa e rentës minerare vetëm për sasinë e planifikuar sipas Projektit të Shfrytëzimit (planifikimi vjetor), që shpërndahet në baza mujore<sup>8</sup>.

Kjo për shkakun se dy ndërmarrje njiheshin si nga përfituesit më të mëdhenjç ndaj kësaj mase. Gjithashtu në Kosovë sektori i Minerave dhe Mineraleve nuk është cilësuar sis humë i ndikuar nga pandemia. Disa përfituesit e kësaj mase janë:

- KEK, e cila ndërmarrje duke u bazuar në inkasimin nga vitet e kaluara përfiton përafërsisht 10,500.000.00 EUR
- NewCo Ferronikeli Complex L.L.C, e cila ndërmarrje duke u bazuar në inkasimin nga vitet e kaluara përfiton përafërsisht 700,000.000 EUR

Dhe se ndikimi i saj drejtpërdrejtë në zhvillimin dhe rimëkëmbjen ekonomike të vendit nuk është vlerësuar si shumë i lartë.


[content/uploads/2021/01/Vendimi-01\\_2021-per-Lirimin-nga-Pagesa-e-Rentes-Minerare-shq.pdf](content/uploads/2021/01/Vendimi-01_2021-per-Lirimin-nga-Pagesa-e-Rentes-Minerare-shq.pdf) (e qasur në qershor, 2021)

## - Masa 10 – BRE

### Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë

#### Objektivi:

Subvencionimi i tarifave të energjisë së përdorur nga Burimet e Ripërtritshme të Energjisë Elektrike për pesë muajt e parë të vitit 2021.



Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike ka paraparë subvencionimin e energjisë elektrike e cila përfitohet nga Burimet e Ripërtritshme të Energjisë. Sa i përket kësaj, pjesa e energjisë elektrike që ata paguajnë për energjinë elektrike që e marrin nga prodhuesit e energjisë nga BRE-të është subvencionuar nga Qeveria e Kosovës. Kjo, pasi Qeveria në bazë të ligjit kishte ndarë një shumë deri në 8 - 16 milionë euro, e cila do t'u jepet atyre prodhuesve përmes KOSTT-it.

Pra, mjetet janë derdhur në këtë kompani nga buxheti i Qeverisë së Kosovës, ndërsa nga aty tek prodhuesit. Ky subvencionim do të zgjaste nga janari deri në maj 2021. Kjo nënkupton që shuma që e përfitojnë këta prodhues gjatë prodhimit nga BRE-të, do t'ju zbritet konsumatorëve në faturat e tyre.

Subvencionimi i tarifave të energjisë së shpenzuar nga Burimet e Ripërtritshme të Energjisë Elektrike e përcaktuar përmes Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike ka gjetur zbatim të jo të plotë në praktikë. Kjo pasiqë përmes këtij ligji ishte paraparë që ky subvencionim të ishte pesë muajor duke filluar nga janari 2021 deri në muajin maj 2021. Mirëpo, Qeveria e Kosovës për këtë masë kishte ndarë vetëm 8 milion euro, mjete këto të pamjafutëshme sipas ndërmarrjes KOSTT për subvencionimin e tërësishëm të planifikuar deri në muajin maj 2021.

Prandaj ky subvencionim u përmbush vetëm në tre muajt e parë të vitit 2021. Kjo bëri që kjo masë të jetë e mangët sa i përket zbatimit dhe se nuk ka informacione në lidhje me dy muajt e mbetur, duke theksuar këshut se në ligj ishte paraparë mbulueshmëria e tërësishme e kësaj mase. Prandaj, kërkesa për subvencionimin e dy muajve të mbetur është e nevojshme për të u përmbushur si masë për përkrahje të qytetarëve të Kosovës.

---

## Përfundime

Themelimi i dritares garantuese sa i përket rimëkëmbjes ekonomike është zbatuar. Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë ka krijuar dritaren garantuese me sektorët e ndarë të cilët vazhdojnë të jenë aktiv deri në fund të vitit 2021. Vlera e kredive dhe vlera e garancisë është rritur për 40% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës ka zbatuar tërësisht masën e përcaktuar përmes nenit 5 të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Gjatë periudhës pesëmuajore, qytetarët patën mundësi të tërheqin 10% të tërësisë së kursimeve të tyre. Kjo masë pati impakt të drejtpërdrejt në ekonominë e vendit, pasi që hynë direkt në ekonominë e vendit.

Ulja e tatimit mbi vlerën e shtuar për sektorin e gastronomisë është duke u zbatuar. Që nga fillimi i vitit 2021, Administrata Tatimore e Kosovës ka filluar zbatimin e kësaj masë dhe po vazhdon zbatimin e tij deri në fund të vitit 2021. Përfitues të kësaj mase janë kryesisht të destianur për furnizimin e hoteleve, restoranteve dhe shërbimeve të ushqimit. Kjo masë po ndikon drejtpërdrejt në rimëkëmbjen e këtij sektori, duke ndihmuar kështu në rimëkëmbjen ekonomike të sektorit të gastronomisë.

Masa e katërt e paraparë për përkrahjen e tatimpaguesve gjatë periudhës së pandemisë është tërësisht e pazbatueshme nga ana e Qeverisë. Kjo masë ka përfshirë periudhën janar 2020 deri dhjetor 2020, periudhë kjo e cila është e pakoordinuar duke pasur parasysh se vetë Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike është miratuar në fund të vitit 2020, duke mos lënë kështu kohë të mjaftueshme për zbatim të kësaj mase. Kjo masë vlerësohet si tërësisht e pazbatuar dhe pa ndikim në rimëkëmbje ekonomike të vendit.

Shuma e përcaktuar përmes Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike për përkrahjen e ndërmarrjeve private ka filluar shumë vonë. Deri vonë kjo masë ka mbetur e pazbatuar, deri në muajin prill kur Qeveria e Kosovës miratoi vendimin e radhës Nr. 08/08, i cili hyn në fuqi me datë 21.04.202. Përmes këtij vendimi Qeveria ndajti 6 milion euro për përkrahjen e bizneseve të cilat hynë në kuadër të shumës së përcaktuar nga kjo masë.

Masa e shtatë e cila ka paraparë pagesën e pagave të puntorëve të cilët janë pezulluar ose larguar nga puna gjatë periudhës së pandemisë është tërësisht e pazbatuar. Kjo masë ka mbetur pezull për shkak edhe të paqartësive të krijuara gjatë përpilimit të kësaj mase. Edhe kjo masë, sikurse masa paraprake ka mbetur e pazbatuar si rezultat i moskoordinimit të datave të paraqitura në Ligjin për Rimëkëmbje ekonomike dhe miratimit të vet ligjit. Vonesat e shkaktuara në miratimin e ligjit dhe mungesa e amendamentimit të ligjit kanë shkaktuar edhe probleme në zbatimin e disa masave të përcaktuara përmes tij.

Prodhuesit e produkteve dhe shërbimeve vendore nuk kanë pasur përkrahje të duhur përmes këtij ligji. Edhe pse përmes nenit 13 të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike është përcaktuar se prodhuesit vendorë do kenë disa përearësi gjatë ofertimeve, mbyllja e kohë pas kohe e vendit ka bërë që kjo masë të mos ketë ndikim e duhur gjatë kësaj kohe. Gjithashtu, mungojnë të dhëna të sakta se sa nga prodhuesit dhe shërbimet vendore kanë përfitur nga kjo masë dhe se sa pritjet të përfitojnë deri në fund të vitit 2021.

---

Masa e cila ka përcaktuar për lirim nga renta minerare për të gjitha subjektet të cilat janë të obliguar për të paguar atë është zbatuar tërësisht. Edhe pse rreth kësaj masë ka pasur kundërshtime duke pasur parasysh se përfitues kryesor dhe më të mëdhenj kanë qenë dy ndërmarrje kryesore, kjo masë është zbatuar tërësisht. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në mënyrë që të parandalohet mbishfrytëzimi i eksploatimit, ka bërë plotësim/ndryshimin e këtij vendimi duke qartësuar që subjektet, në këtë rast ndërmarrjet, do të lirohen nga pagesa e rentës minerare vetëm për sasinë e planifikuar sipas Projektit të Shfrytëzimit.

Subvencionimi i energjisë elektrike të shfrytëzuara nga Burimet e Ripërtritshme të Energjisë Elektrike nuk është zbatuar tërësisht. Kjo masë është paraparë të zbatohet gjatë pesomujorit të parë të vitit 2021, mirëpo është zbatuar vetëm gjatë tremujorit të parë. Kjo për shkak se Qeveria e Kosovës i ka ndarë nga buxheti i saj shumën prej 8 milion euro, shumë kjo që sipas KOSTT nuk ka qenë e mjaftueshme për mbulimin e tërësishëm të kësaj mase.



---

## Rekomandime

- Çfarëdo pako e re e rimëkëmbjes duhet të paraprihet me diskutime të gjera shoqërore dhe ndër-sektoriale. Përzgjedhja e sektorëve për intervenim duhet të bëhet bazuar në një set të kritereve që marrin parasysh nivelin e afektimit nga pandemia Covid-19, nivelin e ndryshimeve të gjelbra që paraqesin këto ndryshime etj. Për dallim nga ky Ligj dhe pakot që kanë rrjedhur nga ky Ligj, çfarëdo pako tjetër duhet të përmbaj objektiva të matshme, mekanizma të monitorimit të progresit dhe raportimit të rezultateve në mënyrë që të matet impakti në ekonomi.
- Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive duhet të ndërtoj mekanizma që i përgjigjen tregut, dhe sidomos bizneseve më të prekura nga pandemia, me masa që lehtësojnë procedurat dhe mundësojnë efekt më të madh ekonomik. Përveç kësaj, një raportim sistematik i të dhënave nevojitet nga ana e Fondit, qoftë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës qoftë në uebsajtin e Fondit në mënyrë që të matet suksesi i dritareve të reja që rrjedhin nga Ligji në krahasim me pritjet e tij.
- Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës duhet të përpiloj një raport të detajuar mbi procesin e tërrehjes së shumës prej 10% përfshirë profilin e personave që kanë tërhequr shumat, nivelin e tërheqjes etj. Gjithashtu, në bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Fondi duhet të zhvilloj një analizë të bazuar në anketë në lidhje me format e shpenzimit të shumës së tërhequr si dhe rolit të kësaj politike në zbutjen e efekteve të pandemisë.
- Qeveria e Kosovës, përkatësisht ATK-ja duhet të raportoj në detaje mbi efektet e uljes së TVSH-së për sektorin e gastronomisë. Me theks të veçantë, ekzaminime duhet të bëhen për të përcaktuar nëse kjo masë ka ndikuar në nivelin e punësimit në sektorin e gastronomisë dhe në uljen e ekonomisë informale. Si masë shtesë, Qeveria në bashkëpunim me shoqatat e gastronomëve duhet të përpilojë një strategji të luftimit të përhapjes së pandemive dhe sëmundjeve ngjitëse nga sektori i gastronomisë. Fushata vetëdijësuese me gastronomët duhet të mbahen në mënyrë që të rritet niveli i përgjegjësisë ndaj shëndetit publik.
- Duke qenë se masa e katërt e paraparë për përkrahjen e tatimpaguesve nuk ka mundur të zbatohet fare për shkak të miratimit të vonëshëm të Ligjit, Qeveria e tanishme duhet ta konsideroj të njëjtën masë për pakot e ardhshme. Paraprakisht, si edhe për çdo masë tjetër, duhet të zhvillohen diskutime të theksuara mbi nivelin e dëmit nga pandemia për këtë grup të targetuar, objektivat e matshme për t'u mbërritur dhe nivelin e zbatimit të tyre.
- Përkrahja e ndërmarrjeve private, dhe veçanërisht bizneseve të reja dhe investimeve që rrisin eficiencën e energjisë dhe ulin ndotjen duhet të prioritetizohet në pakot e ardhshme. Kjo masë bëhet edhe më e rëndësishme kur i shtojmë faktin që nuk ka pasur nivel të kënaqshëm të zbatimit të dispozitave për masën për ndërmarrjet.
- Çfarëdo mase e ardhshme apo pako e ardhshme duhet të ketë parasysh përkrahjen e sektorit të prodhimit dhe sektorëve që gjenerojnë vende të gjelbra pune. Duke përkrahur sektorin e prodhimit, krijohen mundësi që ky sektor të realizoj investime të cilat ndihmojnë në përgatitjen e tij për eksport jashtë vendit dhe për standardizim të produkteve. Masat që

---

ndihmojnë në dekarbonizimin e sektorit të prodhimit apo uljes së intensitetit të emetimeve të karbonit janë gjithashtu të domosdoshme.

- Çfarëdo mase e ardhshme duhet të konsultohet me Komisionin e Ndihmës Shtetërore. Masa për lirim nga pagesa e rentës minerare qartazi ka vënë KEK-un në pozitë dominuese në tregun e energjisë duke i dhuruar 10 milion euro pa pasur fare dëme nga pandemia. Rrjedhimisht, në tregun e energjisë, një ndërmarrje që tashmë gëzonte monopol është subvencionuar edhe me 10 milion euro shtesë të paarsyueshme.